



UNIVERSITETI[®]
METROPOLITAN
TIRANA

UNIVERSITETI “METROPOLITAN TIRANA”

RREGULLORE

E

NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË
CILËSISË

Tiranë 2019





PËRMBAJTJA


Misioni

Objektivat

Politikat

Struktura Organizative

Emërimet, varësitë, detyrat, përgjegjësitë, arsimimet, aftësitë, eksperiencat



MISIONI

NJSBC

- Ndërtimi, mirëmbajtja dhe auditimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UMT.
- Përcaktimi, orjentimi, monitorimi dhe kontrolli i përgjegjësi në lidhje me cilësinë në të gjitha hallkat organizative të UMT, nga Rektori dhe deri tek departamentet e UMT, si dhe me menaxhimin e cilësisë në këto hallka.
- Kryerja e vetëvlerësimit të cilësisë në UMT dhe bashkpunimi për vlerësimin e jashtëm të saj (akreditimin).

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE NË FUSHËN E CILËSISË (afatgjatë, përdurha 5 vjeçare)

Përmirësimi i vazhdueshëm i kulturës së cilësisë në UMT: Akreditimi /riakreditimi i të gjithë programeve të studimit dhe akreditimi/riakreditimi institucional i UMT.

POLITIKA NË FUSHËN E CILËSISË

- Bashkpunimi i vazhdueshëm dhe frekuent i Rektoratit me NJSBC për rritjen e nivelit të Cilësisë në të gjithë aktivitetet që zhvillohen në UMT.
- Nxitja dhe mbështetja e përmirësimit të vazhdueshëm të funksionimit të NJSBC.
- Nxitja dhe mbështetja e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UMT.
- Trajnimi i vazhdueshëm profesional i personelit të NJSBC dhe i anëtarëve të rrjetit të cilësisë pranë kësaj Qendre dhe anëtarëve të tjerë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.
- Sensibilizimi i vazhdueshëm i të gjithë stafëve (akademik, ndihmës administrativ) dhe studentëve të UMT për problemin e cilësisë.
- Trajnime të stafëve (akademik, ndihmës, administrative) dhe studentëve të UMT në fushën e cilësisë.
- Implementimi i plotë i parimeve të menaxhimit të cilësisë dhe i funksioneve të menaxhimit të cilësisë në realizimin e proceseve të mësimdhënies, të proceseve të kërkimit dhe proceseve të tjera.



EMËRIMET, VARËSITE

Neni 1

NJSBC në Universitetin METROPOLITAN - TIRANA është ngritur dhe funksionon bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015,

Neni 2

NJSBC në Universitetin METROPOLITAN - TIRANA ka për funksion drejtimin dhe monitorimin e Procesit të ngritjes dhe funksionimit të sistemit të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Neni 3

NJSBC në Universitetin METROPOLITAN - TIRANA është pjesë e Rektoratit të UMT dhe varet nga Rektori i UMT.

Neni 4

NJSBC në Universitetin METROPOLITAN - TIRANA është ngritur me vendim të senatit të UMT,

Neni 5

NJSBC bashkëpunon me studentët në ushtrimin e funksioneve të veta. Të paktën një student nga një njësi kryesore është përfshirë në grupe e cilësisë pranë tyre.


Neni 6

NJSBC ka autonominë operative dhe akses në të gjitha të dhënat e UMT.

ORGANIZIMI I NJSBC

Neni 7

NJSBC në Universitet METROPOLITAN - TIRANA përbëhet nga Kryetari dhe Anëtarët. Përgjegjësitë e secilit përcaktohen në nenin 8,9 të kësaj rregulloreje. Në përbërje të NJSBC janë nga një përfaqësues nga fakultetet si dhe një përfaqësues nga studentët.



DETYRAT

Neni 8

Detyrat e Kryetarit të NJSBC në Universitetin METROPOLITAN - TIRANA:

- Planifikon, drejton dhe organizon gjithë aktivitetet e NJSBC;
- Përgjigjet para mbledhjes së rektoratit për realizimin e detyrave të tij;
- Organizon dhe monitoron punën e njësive kryesore në UMT për ngritjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të cilësisë të programeve të studimit dhe të institucionit
- Organizon punën dhe harton draftet e procedurave, formularëve të cilësisë dhe i kalon për miratim Rektorit të UMT;
- Organizon punën e arkivimit dhe kodifikimit të dokumentacionit të cilësisë për çdo njësi kryesore dhe të Universitetit;
- Organizon punën e hartimit të drafteve të rregulloreve të UMT në bashkpunim me njësitë kryesore, drejtorinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Rektorat;
- Organizon punën e hartimit të manualit të cilësisë së Universitetit METROPOLITAN - TIRANA;
- Harton planin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në njësitë kryesore, programet e studimit, dhe në Rektorat
- Organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë në njësi kryesore, programet e studimit, dhe në rektorat
- Është përgjegjës për nxjerrjen e rezultateve dhe rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë.
- Është përgjegjës për publikimin e rezultateve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë
- Merr pjesë në formulimin e kërkesës për akreditim dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit të cilësisë në institucion

Neni 9

Arsimimi, aftësitë dhe eksperiencat e Kryetarit të NJSBC:

- Të jetë pedagog me përvojë të gjatë në UMT
- Të ketë të paktën gradën Doktor

Neni 10

Anëtarët i NJSBC emërohet nga Rektori dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të NJSBC

Detyrat e anëtarëve të NJSBC:

- Të disponojë dhe të studiojë të gjithë materialet e shkruara që lidhen me aktet ligjore dhe nënligjore, me urdherat dhe udhëzimet e ministrisë, me Statutin dhe rregullat, etj., të cilët kanë të bëjnë me plotësimin e misionit që ka struktura e NJSBC
- Të njihet dhe konsultohet vazhdimisht me Ligjin "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Standartet Shtetërore, si dhe me aktet nënligjore që e shoqërojnë ato, me Statutin e UMT, me Rregulloren Mësimore të UMT dhe rregulloret e tjera me interes të UMT
- Të hartojë planin vjetor të punës së tij dhe t'a miratojë me të Drejtorin e NJSBC



- Te bashkepusoje me Drejtorin e NJSBC per ndertimin e indikatorëve te performances vjetore te punes se tij
- Te pergjigjet para drejtorit të qëndrës për realizimin e detyrave të ngarkuara dhe te pergatise "Raportin vjetor te punes"
- Te realizoje koordinimin e punës dhe komunikimin e NJSBC me njësitë kryesore të UMT dhe Rektoratin e UMT;
- Te marre pjesë në hartimin e drafteve të procedurave dhe formularëve të cilësisë
- është përgjegjës për arkivimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të dokumentave të vjetruara të cilësisë;
- është përgjegjës për kodifikimin e dokumentacionit të cilësisë;
- merr pjesë në organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në njësitë kryesore dhe në rektorat;
- merr pjesë në nxjerrjen e rezultateve dhe rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë;
- merr pjesë në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për kërkesën e akreditimit;
- përditëson materialet publike në stenda dhe në faqesite

Neni 11

Arsimimi, aftësitë dhe eksperiencia e Anëtarit të NJSBC:

- Të këtë diplomë universitare (preferohet nga UMT);
- Të njohë gjuhën angleze (me dëshmi nga U.T ose çertifikata ndërkombetare);
- Të ketë njohuri bazë të kompjuterit dhe të njohë programet kryesore kompjuterike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;

Neni 12

Detyrat e përfaqësuesit të fakultetit pranë NJSBC:

- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet e qëndrës
- Është kryetar i GV per fakultetin
- Planifikon dhe organizon punën e GV gjatë procesit të vetëvlerësimit
- Është përgjegjës për raportin e Vetëvlerësimit të fakultetit
- Merr pjesë në trajnimet që zhvillohen nga qëndra ose nëpërmjet qëndrës

Neni 13

Detyrat e përfaqësuesit të administratës pranë NJSBC:

- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet e qëndrës
- Është përgjegjës për një pjesë raportin e Vetëvlerësimit institucional
- Merr pjesë në trajnimet që zhvillohen nga qëndra ose nëpërmjet qëndrës

Neni 14

Detyrat e përfaqësuesit të Studenteve pranë NJSBC:

- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet e qëndrës
- Ndihmon në shpërndarjen e pyetësorëve dhe mbledhjen e informacioneve nga studentët.
- Merr pjesë në trajnimet që zhvillohen nga qëndra ose nëpërmjet qëndrës

